



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.10.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 15 tetor - 02 nëntor 2018.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 8 tetor 2018.
3. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, dhe protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001”.  
*(Komision për dhënie mendimi)*
4. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”. *(Komision për dhënie mendimi)*

#### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Arben Pëllumbi, Xhemal Qefalia.

**Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Vasilika Hysi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Rovena Voda - zëvendësministre e Brendshme

Elona Hoxhaj - drejtore juridike, Ministria e Brendshme

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Danjela Çekani - drejtore, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Kuorumi formohet, kështu që vazhdojmë me çështjet që kemi në rendin e ditës.

Kemi katër çështje për shqyrtim.

E para është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 15 tetor - 02 nëntor 2018. A ka vërejtje për kalendarin? A ka sugjerime? Nuk ka.

Miratohet kalendar i punimeve të komisionit për periudhën 15 tetor - 2 nëntor 2018.

Kalojmë në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 8 tetor 2018. Procesverbalet e kësaj mbledhje ju janë dërguar nëpërmjet postës elektronike. A jeni dakord me procesverbalin? A ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohet procesverbali i mbledhjes së komisionit të datës 8 tetor 2018.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Lundrimit Detar, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, dhe protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001”. Komisioni ynë është për komision dhënie mendimi. Relator i kësaj marrëveshje është kolegu Edmond Leka.

Nga Ministria e Brendshme kanë konfirmuar pjesëmarrjen: zonja Rovena Voda, zëvendësministre dhe zonja Elona Hoxhaj, drejtoreshë Juridike.

Zonja Voda, mirë se keni ardhur në komision! Ju lutem, bëni shkurt një prezantim të kësaj marrëveshje për kolegët e komisionit. Pastaj do t’ia kaloj fjalën kolegut Edmond Leka.

Fjala është për ju.

**Rovena Voda** – Mirëdita!

Protokollet e këtyre konventave janë iniciuar në kuadër të legjislacionit kombëtar për shkak se, në bazë të ligjit “Për kontrollin kufitar në Republikën e Shqipërisë”, është pikërisht Policia e Shtetit, Departamenti i Kufirit dhe Migracionit, i cili mbulon kontrollin e territorit të Republikës së Shqipërisë, madje jo vetëm pikat e kalimit kufitar, por edhe kufirin e gjelbër, kufirin

tokësor, dhe kufirin blu, kufirin detar. Sigurisht që protokollet e këtyre konventave lidhen me mbarëvajtjen e paqes dhe sigurisë së lundrimit ndërkombëtar, duke promovuar sigurinë, marrëdhëniet miqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare. Në fakt, aderimi në këta organizma synon të forcojë bashkëpunimin në përmirësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës Ndërkombëtare Detare për të rritur efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, si një nga format e krimit, ndoshta edhe një sfidë për sigurinë e të gjitha shteteve të Europës, pra jo vetëm të rajonit, por edhe të gjitha vendeve anëtare të BE-së.

Është parë i nevojshëm aderimi në këto protokolle të konventave, duke iu referuar seriozitetit të organizatës, shteteve anëtarë dhe nevojës për të marrë masa të përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizimit nëpërmjet rrugëve detare. Sigurisht që palët priren të realizojnë objektivat e tyre në lidhje me evidentimin e shkeljeve që do të ndodhin në kufirin detar. Në këto protokolle pjesa më e rëndësishme, ndoshta për mua, është mënyra sesi do të rregullohet shkëmbimi i informacionit në rastet e veprave penale në pjesën e kufirit detar. Shkëmbimi i informacionit është i rregulluar në një nga këto protokolle dhe ka një ndryshim përkatës në pjesën sesi do të bëhet ky shkëmbim, ndërsa pjesa më e detajuar do të bëhet në marrëveshje midis palëve me marrëveshje pune ose me protokolle të veçanta.

Përparësitë që priten nga aderimi i Republikës së Shqipërisë në protokollet e konventave lidhen me goditjen e krimit dhe akteve terroristeve, ku palët do të marrin masa të përbashkëta kundër akteve të kundërligjshme detare duke bërë të mundur goditjen e tyre, por fjala kyçe mbetet bashkëpunimi me vendet anëtare të Organizatës Ndërkombëtare Detare. Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Voda!

Fjalën e ka relatori, zoti Leka.

**Edmond Leka** – Faleminderit kryetar!

Nëpërmjet këtij projektligji synohet aderimi i Republikës së Shqipërisë në konventën për ndalimin e akteve të paligjshme kundër sigurisë së lundrimit detar dhe ndalimit të akteve të paligjshme kundër sigurisë së platformave fikse. Aderimi në këto protokolle të konventave kryhet në kuadër të përmbushjes së luftës kundër krimit në tërësi, goditjes së trafikimit dhe akteve terroriste, të cilat synojnë të realizohen vetëm në rrugë detare.

Aderimi në protokoll është iniciuar mbi bazën dhe frymën e respektit të marrëveshjes ndërkombëtare dhe në pajtim me legjislacionin kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Unë kam disa pyetje për zonjën zëvendësministre.

Pse aderimi në këto dy protokolle bëhet me të njëjtin ligj, duke qenë se kemi të bëjmë me dy protokolle të ndryshme? A keni informacion për peshkimin e paligjshëm, që kryhet në ujërat tona? Çfarë masash merren për peshkarexhet, që peshkojnë në ujërat tona, duke e ditur se ato janë me shpejtësi të lartë dhe krijojnë mundësi për trafikim si të drogërave ashtu edhe të veprave të ndryshme penale? A ekziston informacioni për peshkarexhet me shpejtësi të larta?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Leka!

Përfaqësuesit e Ministrisë ë Brendshme mund t’u përgjigjen pyetjeve të kolegut.

**Rovena Voda** – Besoj se aderimi në këto protokolle është përdorur si bazë ligji, i cili ka miratuar konventën, duke qenë se këto janë protokolle që ndjekin konventën për të cilën jemi palë dhe e kemi ratifikuar para këtyre dy protokolleve shtesë. Besoj se kjo është logjika juridike.

Për sa i përket pjesës së peshkimit, pyetja juaj është interesante, por unë dua t’ju përgjigjem me diçka tjetër. Ne, në fakt, kemi pasur ankesa nga shoqata e akuakulturës dhe e të gjithë atyre që merren me peshkim, për shkak të kontrolleve shumë të rrepta që ne ushtrojmë ndaj të gjithë personave fizikë dhe juridikë që merren me peshkimin, pra me këtë aktivitet, që, në fakt, është edhe një biznes fitimprurës në ekonominë tonë. Kjo për faktin se në momentin që peshkarexhat dalin, patjetër duhet një punonjës i Policisë Kufitare të hyjë dhe të bëjë një kontroll, i cili nuk është një kontroll i detajuar, por është një kontroll rutinë, të marrë një fletë dalje dhe pak a shumë të shënohet edhe ora kur kthehet peshkarexha.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Edmond Leka** – Për peshkarexhat e huaja, që janë shumë moderne dhe me shpejtësi shumë të lartë, që peshkojnë në ujërat tona, por që janë edhe burim trafikimi i drogërave.

**Rovena Voda** - Pavarësisht mjeteve të kufizuara logjistike, mbikëqyrja dhe kontrolli i kufirit blu ka qenë në vëmendje të Departamentit të Policisë Kufitare dhe Migracionit.

Më falni, që e keqkuptova pyetjen tuaj, sikurse ne kemi qenë tepër të rreptë në pjesën e kontrollit që u bëjmë peshkarexhave tona, jemi munduar, sigurisht me ato anije që kemi, por edhe në bashkëpunim me rojën bregdetare, dhe këtu dua të falënderoj rojën bregdetare, të cilin e mbulon dhe është në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, që të mbikëqyrim kufirin. Nga të dhënat statistike

që kemi, nuk është se kemi statistika për peshkim të paligjshëm të peshkarexhave të huaja në territorin detar të Republikës së Shqipërisë, bashkëpunimi ka qenë shumë efikas i Departamentit tonë me rojën bregdetare. Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Voda!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

**Arben Pëllumbi** - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Sigurisht, ratifikimi i këtyre projektligjeve gjithmonë ka qenë një prioritet jo vetëm i këtij komisioni. Por, kam një shqetësim, që dua ta ndaj me ju, dhe do të kërkoja një përgjigje nga ana juaj. Çfarë impenjimesh financiare ka aderimi në këto lloj konventash dhe burimesh njerëzore? Pra, ideja është aderojmë dhe jemi gati, apo aderojmë dhe do të përgatitemi në të ardhmen, nga ana financiare dhe e burimeve njerëzore?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Urdhëroni, zonja Voda!

**Rovena Voda** – Faleminderit për pyetjen!

Në fakt, nga një vlerësim që është bërë, sigurisht nga ekspertët që kanë përgatitur këtë draft, ka dalë në konkluzionin se nuk do të ketë kosto shtesë në buxhet për të implementuar aderimin tonë, pra zbatimin e këtyre protokolleve shtesë. Mendoj se është logjike se nuk do të ketë, për arsye se do të jetë staf i Departamentit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, ndoshta kur të jetë i nevojshëm edhe përdorimi i Rojës Bregdetare për të bashkëpunuar në rastin e identifikimit të veprave penale në kufirin detar.

Kjo ishte për sa i përket pjesës së kostove në buxhet.

Për sa u përket burimeve njerëzore, në fakt, është e drejtë se deri diku Policia Detare dhe e Emigracionit është një strukturë brenda Policisë së Shtetit, që, për mendimin tim, është nga më të rëndësishmet, sepse kur flasim për kufij flasim për siguri dhe e dimë shprehjen “kufij të hapur, por të sigurt”.

Gjithmonë ka kërkesa për burime njerëzore në Policinë e Shtetit, të jem e sinqertë. Gjithmonë, kur diskutojmë, ne themi se na duhen njerëz dhe mirë do të jetë për momentin sigurisht

që implementimin e këtyre dy protokolleve shtesë do ta bazojmë në ato burime njerëzore që ne kemi.

Ndoshta më vonë do të kemi një strukturë të re apo shtim të numrit të personelit të Policisë Kufitare dhe Emigracionit, do t'i shikojmë më vonë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Voda!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Zonja zëvendësministre,

Më bën çudi momenti kur vjen ky projektligj apo ndryshim në këtë konventë.

Doja të dija nëse jeni konsultuar, jo thjesht në kuadrin e ardhjes si procedurë nga KM-ja, por nëse jeni konsultuar specifikisht me Ministrinë e Jashtme për sjelljen e këtij projektligji, lidhur me faktin se të sjellësh një projektligj të tillë, së pari, duhet të kesh edhe një interes të drejtpërdrejtë dhe unë doja të dija nëse keni ndonjë platformë fikse.

A ka ndonjë projekt në të ardhmen e afërt?

A ka ndonjë shtysë nga vende partnere apo të tjera lidhur me platformat e tyre, që na nxit ne për të aderuar në këtë konventë apo në këtë protokoll, që ndryshohet me nxitim?

Faleminderit!

**Ulsi Manja** - Urdhëroni, zonja Voda!

**Rovena Voda** – Faleminderit, zoti Hyseni për pyetjet!

Patjetër që ky akt ka kaluar duke zbatuar Rregulloren e KM-së për miratimin projektakteve në qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Akti patjetër që ka kaluar në Ministrinë e Jashtme, sepse është një akt ndërkombëtar. Bazuar edhe në legjislacionin e shkuar, por edhe në ligjin e ri për marrëveshjet ndërkombëtare, çdo akt, çdo marrëveshje ndërinstitucionale dhe jo më akt ndërkombëtar apo protokoll shtesë duhet të kalojë nga Ministria e Jashtme dhe Ministria e Financave.

Kështu që ne e kemi përgjigjen, është konsultuar dhe janë shprehur dakord.

Për sa i përket pyetjes nëse kemi një platformë fikse, mund të them se për momentin unë nuk jam në dijeni që ne të kemi një platformë fikse, pra, po themi një naftëmbajtëse apo një aeroplanmbajtëse, nuk di forma të ndryshme në territorin detar të Republikës së Shqipërisë, por mjafton t'ju them një gjë: filozofia e krimit sot është gjithmonë dy hapa para nesh dhe ne nuk kemi

pse presim që, kur të kemi një platformë fikse, ta miratojnë këtë gjë, se do të ndodhë kjo gjë. Jo. Ne duhet të jemi gjithmonë dy hapa para. Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Voda!

Jemi komision për dhënie mendimi dhe kjo është një nga ato marrëveshje rutinë që kalojnë në Komisionin e Ligjeve. Sigurisht që është nismë e qeverisë. Komisioni përgjegjës besoj se do t'i marrë në konsideratë të gjitha shqetësimet që ngrihen këtu, por unë them të ecim me marrëveshjen sepse kemi edhe marrëveshjen tjetër.

Urdhëroni, zoti Fino për procedurë!

**Bashkim Fino** – Mbledhja po ecën në mënyrë perfekte. Pyetjet që bëjnë kolegët e mi deputetë janë shumë interesante, madje zëvendësministrja edhe i falënderoi me sinqeritet dhe unë që e kam këtu afër e kuptoj. Mirë është të dimë se çka bëhet me këto dy akte, nuk ka ndonjë gjë të keqe nëse bëhet ndonjë pyetje, sepse nuk do të thotë se, duke qenë komision për dhënie mendimi, deputetët të mos kenë të drejtë të bëjnë pyetje për thelbin e çështjes, pavarësisht se ne japim mendim dhe Komisioni i Sigurisë është komision përgjegjës. Kjo nuk do të thotë që një material që ne kemi dhe jemi komision përgjegjës dhe në komisionet e tjera të mos ketë sugjerime, vërejtje apo pyetje nga më të ndryshmet, të cilat na ndihmojnë edhe ne...

**Ulsi Manja** – Dakord. A kemi pyetje?

**Bashkim Fino** – Jo nuk kam, por mënyra e ndërhyrjes suaj bëri që të rezervoni pyetjet e tjera...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** - Zonja Xhina!

**Elena Xhina** – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke qenë para faktit se ky protokoll, në momentin që ne bëhemi pjesë e tij dhe bëhet pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm, pyetja ime është: A ka nevojë për ndryshime apo shtesa në ligjin tonë të brendshëm në momentin që ne bëhemi pjesë e këtij protokollit? Faleminderit!

**Rovena Voda** - Faleminderit!

Në fakt, është e drejtë pyetja juaj, por duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një konventë dhe protokolle shtesë të një konvente të ratifikuar nga parlamenti i Republikës së Shqipërisë, duke pasur parasysh nenin 118 të Kushtetutës së Shqipërisë, hierarkinë e akteve, konventat e ratifikuara vijnë të dytat pas Kushtetutës së RSH-së.



Kjo do të thotë se ato janë direkt të zbatueshme në legjislacionin e brendshëm tonin, kështu që për momentin është ky qëndrim. Më vonë unë nuk mund të flas.

**Ulsi Manja** - Faleminderit! A ka pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime?

Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Kjo është një konventë shumë e rëndësishme se ka lidhje me sigurinë e kufijve tanë dhe ka lidhje me elemente të përcaktuara me koncepte të shelf kontinental, për të cilat unë dhe kolegu Leka jemi të interesuar si deputetë të qarkut Vlorë, sepse, sikurse e dini, RSH-ja është akoma në bisedime për marrëveshjen me Greqinë, pikërisht për këtë element, një nga elementet në diskutim është pikërisht shelf kontinental dhe unë prandaj bëra pyetjen nëse ka ndonjë informacion Ministria e Brendshme, nëse kemi ne platforma, ka Greqia apo ka Italia për territorin për të cilin interesohemi unë dhe zoti Leka, po patjetër edhe për pjesën tjetër të territorit, Mali i Zi që është në Veri.

Për këtë arsye unë shtrova pyetjen që pse vjen kjo marrëveshje në këtë moment.

Unë do të dëshiroja të kisha më tepër mundësi në komisionin përgjegjës për këtë, por, duke qenë se unë në këtë komision ndodhem, e shtroj për diskutim këtu ku ndodhem dhe besoj nuk është vendi i gabuar, duke menduar se RSH-ja duhet t'i shtojë interesat e saj dhe duhet t'i marrë parasysh ato pas konsultimeve edhe me aktorët vendas, edhe në kuadër të interesave ekonomike e të mirëfillta të peshkimit, duke pasur parasysh shqetësimin e peshkatarëve të Vlorës dhe Sarandës e të Himarës, të cilët kanë mjete të amortizuara, dhe vendosja e disa standardeve, të marra apriori nga konventat dhe të pakonsultuara me ta, pa i paragjykuar fare. Do të doja që, ashtu siç është opinioni formal i Ministrisë së Jashtme, të ishte edhe opinioni i Ministrisë së Bujqësisë, pasi të ishte konsultuar me grupin e interesit, me peshkatarët.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Mos u nxitoni, zonja zëvendësministren sepse do ta keni të drejtën e fjalës, por prisni dhe dëgjoni deri në fund. Nuk është vetëm përgjegjësia juaj. Po e shtroj në një kompleks më të gjerë.

Shqetësimi im është që, kur vijmë me kësi konventash, të mos vijmë thjesht me patosin për të aderuar në këto konventa dhe po bëjmë diçka. Problemi është se çdo konventë duhet të sjellë dy elementë: në aspektin e sigurisë, por edhe në moscenimin e interesave të përgjithshme ekonomike të Republikës së Shqipërisë.

Ky ishte shqetësimi që patëm unë dhe kolegu Leka, arsye për të cilën ne ngritëm disa pyetje, në lidhje me të cilat morëm përgjigje, së paku ato përgjigje që ju dispononi, ndonëse kemi rezervat tona. Jo ndaj jush specifikisht, por në përgjithësi, ndaj proceseve të konsultimit të mirëfilltë në lidhje me ardhjen e disa konventave. Ju faleminderit!

**Ulsi Manja** – Jemi në fazën e diskutimeve.

Faleminderit, zoti Hyseni!

Ka diskutime të tjera? Po, zonja Ferhati!

**Klotilda Bushka** – Faleminderit, zoti Manja!

Aderimi në këtë protokoll shtesë të konventës, me sa vërej unë, nga materialet që kam lexuar, ka të bëjë pikërisht me plotësimin e detyrimeve, që konventa bazë e OKB-së i ka ngarkuar shtetit shqiptar, i cili ka qenë pjesë që në fillim, në mënyrë që të zgjerojë disi mbrojtjen e vet, që bëhet ndaj disa veprave penale, të cilat kryhen në ato territore që përfshihen në sektorin e lundrimit.

Ajo që vë re ka të bëjë pikërisht me faktin se ky protokoll i ngarkon shtetet që janë pjesë e Konventës, por edhe e protokollit, me detyrimin që në juridiksionin vendës të plotësojnë klauzolat në lidhje me veprat penale, të cilat janë ato që listohen në protokoll. Me sa shoh, këto vepra janë: përdorimi i lëndëve plasëse, materiale radioaktive, lëshimi i materialeve të dëmshme apo substancat që cenojnë lundrimin e të tjera.

Unë jam shumë e qartë se kjo konventë, sipas materialeve që kam lexuar, pra ky protokoll i ka kaluar të gjitha hallkat procedurale për konsultim me aktorët qeveritarë, por edhe në kuadrin e procedurave për ratifikimin e akteve ndërkombëtare. Nuk kam pyetje, por thjesht një merak: ndoshta në vijim të kësaj konvente dhe të rritjes së efikasitetit të luftës kundër këtyre fenomeneve, që përbëjnë edhe vepra penale, të cilësuar si të tilla nga konventa, ndoshta do të duhet që më pas, organet përkatëse të bëjnë një studim në lidhje me ndryshimet që do të na duhet të ndërmarrim. Kjo ka të bëjë me plotësimin e detyrimeve që na vijnë nga konventa.

I mirëkuptoj të gjithë kolegët për pyetjet që bëjnë, sepse, siç e thamë, nuk ka rëndësi që ne jemi Komisioni i Ligjeve dhe duhet të bëjmë vetëm pyetje që kanë lidhje me Komisionin e Ligjeve. Nga ana tjetër, thelbi i fokusimit të rendi i ditës ka të bëjë pikërisht me nxjerrjen në pah të atyre çështjeve që kanë nevojë të ndiqen.

Unë mendoj se ju, si ministri, e keni në konsideratë këtë, por duhet ta shihni, në mënyrë që, nëse ka nevojë për ndryshime, jo thjesht të miratojmë konventën dhe protokollin, por edhe të

ecim, sepse masat e konventave nuk janë apriori, por kanë rëndësinë e tyre, dhe rëndësia e tyre është që lufta ndaj këtyre fenomeneve të jetë efektive.

Ju falënderoj për këtë akt që keni sjellë sot.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Ka diskutime të tjera? Nuk ka. E hedhim në votim në parim këtë projektligj.

Kush është dakord në parim me projektligjin?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet në parim ky projektligj!

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Neni 2. Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

E hedhim projektligjin për votim në tërësi.

Kush është dakord në tërësi?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin 2005 të Konventës për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Llundrimit Detar, aderuar me ligjin nr. 8850/2001, dhe Protokollin 2005 të Protokollit për Ndalimin e Akteve të Paligjshme Kundër Sigurisë së Platformave Fikse në Shelfin Kontinental, aderuar me ligjin nr. 8850/2001”.

Ky projektligj, së bashku me raportin përkatës të relatorit, do t'i përcillet komisionit përgjegjës e më pas seancës plenare për votim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

## **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 15.10.2018, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja - kryetar i Komisionit**

### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”. *(Komision për dhënie mendimi)*

### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Arben Pëllumbi, Xhemal Qefalia.

### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Vasilika Hysi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka dhe Tom Doshi.

### **Të ftuar:**

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Danjela Çekani - drejtore, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Ulsi Manja** – Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës, që njëkohësisht është edhe i fundit për ditën e sotme: projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Çyrbja. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme: zoti Gazmend Barbullushi, Sekretar i Përgjithshëm, dhe zonja Daniela Çekani, drejtore.

Rifillojmë mbledhjen e komisionit, Ju lutem, le të hyjnë mediet brenda.

Relatori, zoti Çyrbja.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që është “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Zoti Barbullushi, mirë se erdhët në komision! Do t’ju lutesha që, për kolegët e komisionit, por edhe për opinionin publik, të bënit një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje. Fjala është për ju!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ndizeni mikrofonin!

Mund të filloni nga fillimi.

**Gazmend Barbullushi** - Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare krijon kushtet për zbatimin e përbashkët të projekteve midis Shqipërisë dhe Kosovës, duke mundësuar përfitues dhe në të dyja vendet të shkëmbehen njohuri, përvoja, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme në sektorët e mjedisit, turizmit, punësimit e të tjerë.

Ky projektligj për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje është propozuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.536 të vitit 2018. Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.249 të vitit 2017, është nënshkruar nga pala jonë në korrik të vitit 2017 dhe është përfunduar nga pala kosovare në nëntor të vitit 2017.

Programit i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri Kosovë 2014-2020 është miratuar nga komisioni me vendimin e tij zbatues të dhjetorit të vitit 2014. Alokimet e vitit 2018 në këtë program

financohen nga një grant i BE-së nëpërmjet instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPA, me një buxhet total për të dyja vendet më shumë se sa 1 milion e 400 mijë euro.

Bashkëfinancimi kombëtar i përbashkët i të dyja vendeve është në nivelin e 180 mijë eurove, ndërsa vetë kontributi i BE-së është në nivelin e 1 milion e 200 mijë eurove.

Zona e programit ku do të zbatohen projektet mbulon një territor më shumë sesa 8 mijë kilometra katrorë nga të dyja anët e kufirit, me një popullatë rreth 940 mijë banorë.

Në Shqipëri zonat përfituese përfshijnë rajonet, qarqet e Kukësit dhe të Lezhës, ndërsa në Kosovë rajonin ekonomik Perëndimor dhe Jugor. Programi i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë mbështet bashkëpunimin e eksperiencës, të njohurive dhe përmirësimin e politikave publike mes autoritete kombëtare, lokale dhe rajonale. Ka qëllim kryesor që të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave, si edhe të forcojë më tej bashkëpunimin e natyrshëm mes dy shteteve. Duke marrë në konsideratë problematikën në terren, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme.

Së pari, në mbrojtjen e mjedisit, përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimaterike, parandalimin dhe menaxhimin e riskut.

Së dyti, në turizëm, në trashëgiminë natyrore dhe atë kulturore. Së fundi, të rinia, arsimi me fokus nxitjen e punësimit.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Më falni për përshkrimin e shkurtër, por jam në dispozicionin tuaj!

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zoti Barbullushi!

Fjalën e ka relatori, zoti Çyrbja.

**Jurgis Çyrbja** – Faleminderit, zoti kryetar!

Nëpërmjet këtij projektligji të propozuar synohet ratifikimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA 2, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016.

Programi i bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri - Kosovë 2014 u miratua nga Komisioni European në datën 11 dhjetor të vitit 2014. Alokimet e vitit 2016 për këtë program financohen nga një grant i BE-së nëpërmjet instrumentit të asistencës të paraanëtarësimit me një buxhet total

për të dyja vendet prej 1 milion e 411 mijë e 765 euro nga të cilat 180 mijë euro përbëjnë bashkëfinancimin kombëtar të shteteve dhe 1 milion e 200 mijë euro është kontributi i BE-së.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri- Kosovë mbështetet në shkëmbimin e eksperiencës së njohurive dhe përmirësimit të politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare rajonale dhe lokale, si edhe aktorëve të tjerë të rajoneve të lejueshme në zonën e programit.

Programi ka si qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të zonave, si edhe të forcojë më tej bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve.

Në këto kushte, u kërkoj anëtarëve të komisionit që ta miratojmë këtë projektligj kaq të rëndësishëm.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka pyetje nga kolegët?

**Jurgis Çyrbja** – Kam një pyetje për zotin Barbullushi. Duke marrë në konsideratë faktin që marrëveshja është miratuar në parim dhe është nënshkruar për palën shqiptare në korrik të vitit 2017, cila është arsyeja e paraqitjes së saj për ratifikim pas më shumë se një viti?

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Po, zoti Barbullushi.

**Gazmend Barbullushi** -Këto janë procedura normale, standarde, të komisionit që ndjekin të gjitha vendet për këto bashkëpunime ndërkufitare. Nuk ka ndonjë arsye të veçantë, por është thjesht një procedurë, që në këtë kohë ne bëjmë miratimin, ratifikimin me ligj të marrëveshjes për këtë bashkëpunim kufitar.

**Jurgis Çyrbja** - Si në këtë kohë, sepse nuk e kuptova?

**Gazmend Barbullushi** – Pra, siç e thoni edhe ju, një vit e gjysmë më pas.

**Ulsi Manja** - Pra, nga vitit 2017, është procedurë standarde.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Jurgis Çyrbja** - Kam edhe një pyetje tjetër. Cili ka qenë impakti i procesit të konsultimit të programit dhe sa është numri i projektpropozimeve që kanë aplikuar deri tani dhe në cilat fusha?

**Gazmend Barbullushi** - Projektpropozimet janë diskutuar të gjitha në terren bashkë me komisionin. Impakti është i tillë që janë përfituar shumë projekte. Sot unë nuk mund të jap numrin

e projekteve, sepse jam i shoqëruar me drejtoreshën e Departamentit, e cila po vjen ndërkohë. Nuk jua jap dot fiks, por do t'jua sjell me shkrim.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Barbullushi!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Barbullushi!

Kam disa pyetje, por disa prej tyre relatori i kishte kapur drejt dhe saktë. Më duhet të them se ne paskemi vetëm një zonë përfituese, ku përfshijmë vetëm rajonin e Kukësit, që nuk quhet rajon, por Bashkia e Kukësit dhe Bashkia e Lezhës, ndërkohë që Kosova ka përfitim në 8 bashki me 362 vendbanime. Më duket disproporcion pak jo i drejtë në raport me Kosovën, kur ky projekt është i përbashkët Shqipëri- Kosovë: ne 2 bashki, ata 8 bashki. Pse ndodh një gjë e tillë? Ju keni një grup pune të përbashkët, Shqipëria dhe Kosova bashkëpunojnë me delegacionin e BE-së këtu në Tiranë, sipas informacionit dhe relacionit që keni për koordinimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të programit. Dua të di, pse ky disnivel?

E dyta, duhet t'ua shpjegoni anëtarëve të komisionit, unë e kuptoj, pra është fjala për raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, pasi kjo më intereson. Në këtë fazë thoni ju në relacion është e pamundur që të jepet një vlerësim i të ardhurave dhe shpenzimeve për shkak se një ndarje e buxhetit prej 1 milion e 380 mijë eurosh për secilin shtet: edhe ne, edhe Kosova, të alokuar në vitin 2016, ku bashkëfinancimi kombëtar është: ne japim 180 mijë euro dhe kontributi i BE-së është 1 milion e 200 mijë euro, mund të bëhet pas kontraktimit të projekteve fituese nga thirrja e dytë e projektpropozimeve. Përveç atyre që thashë më lart, ne kemi projekte fituese për sa i përket raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve? Këtu na del se ka vetëm 2 bashki, ndërkohë që këtu na del se ne më duket sikur nuk kemi projekte përfituese, pavarësisht se këto projekte i përfitojnë institucionet shtetërore, por, natyrisht, edhe shoqatat apo OJF të tjera.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zoti Barbullushi.

**Gazmend Barbullushi** – Atëherë, pamundësia për të llogaritur me precizion, le të themi, kontributet, vjen nga fakti se është e hapur mundësia të aplikojnë qoftë institucionet shtetërore,



ashtu edhe institucionet joshtetërore, natyrisht subjekte që gjejnë partnerë nga ana tjetër e kufirit dhe bashkërisht përfitojnë projekte, sepse në rastin e institucioneve shtetërore angazhimi mbulohet nga shteti, ndërsa në rastin e institucioneve private, joshtetërore, angazhimet mbulohen nga vetë subjektet.

Për këtë arsye ne do të presim projektet, do të shohim se cilat prej tyre do të jenë fituese dhe më tej do të jemi në gjendje të llogarisim angazhimin e buxhetit të shtetit në këto raste.

Shuma 180 mijë euro është bashkëfinansim i të dyja shteteve. Kështu që, edhe këtu, në avancë, është e pamundur të themi se sa do të paguajnë subjektet e projekteve shqiptare dhe kosovare.

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Natyrisht, këto janë hapësirat në qoftë se të gjitha llogariten nëpërmjet procedurave të sakta të komisionit dhe, natyrisht, monitorohen nga delegacioni.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për sa i përket pyetjes, së cilës nuk pata mundësi t'i përgjigjem saktësisht...

**Ulsi Manja** – Ajo lidhur me aplikimet rreth projektit.

**Gazmend Barbullushi** – Po, me numrin e aplikimeve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Danjela Çekani** – Fillimisht, ju kërkoj ndjesë për vonesën, pasi sapo përfundoi komisioni paraardhës.

Aktualisht, ky program ka lançuar vetëm një thirrje për projektpropozime. Në terma numerikë janë ndoshta rreth 12 aplikime. Nuk mund të shprehem aktualisht për një numër të saktë, pasi nuk disponoj një databazë, por më tepër mund t'ju shpjegoj lidhur me procesin e aplikimeve.

Duke qenë se ky program përfshin dy vende, pra Shqipërinë dhe Kosovën, procesi i aplikimit bëhet ndërmjet partneriteteve të palëve të interesuara që u përkasin këtyre dy vendeve. Sigurisht, partneritetet kanë një numër minimum dhe maksimum aplikantësh, ku minimumi mund të jetë tre, kurse maksimumi deri në shtatë. Secili prej këtyre partneriteteve fokusohet në një prioritet të programit ndër disa të tillë që programi ka lançuar.

Në rastin me programet për Kosovën janë tre prioritete. Partneritetet në këtë rast, në funksion edhe të fushës së tyre të veprimit, mund të aplikojnë në njërin prej tyre. Sigurisht, procesi i përzgjedhjes së projekteve fituese bëhet nëpërmjet një strukture të veçantë, që, në këtë rast, është

delegacioni i BE-së në rolin e autoritetit kontraktor, i cili, nëpërmjet një procesi të hapur, bën thirrjen për aplikimet për ekspertë të jashtëm, pra bën përzgjedhjen e tyre në varësi të kriterëve. Pastaj është pikërisht ky grup ekspertësh, i cili në fund del me një rezultat lidhur me numrin e projekteve fituese.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Ka diskutime?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Fjalën e ka zoti Fino, për diskutim.

**Bashkim Fino** – Ky është një projektligj që është i vonuar, siç e tha edhe relatori, duhet të kishte ardhur më shpejt, pavarësisht përgjigjes burokratike që dha sekretari i Përgjithshëm, se procedura duhet të jetë kështu për një vit, por unë nuk mendoj se është kështu, pasi nëse ne kemi një program bashkëpunimi për vitin 2014-2020, sot jemi në vitin 2018 dhe, të thuash sot se është e pamundur të jepet vlerësimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve të buxhetit prej 1 milion e 380 mijë, që është përfitues i alokimit, të mos harrojmë, të i vitit 2016, dhe të thuash: “Sot nuk kam të dhëna për të treguar sa janë të ardhurat dhe shpenzimet”, në një kohë kur ne e miratojmë në parlament në vitin 2018...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Pra, si projekt ju ka filluar më shpejt, e kupton, mua më duket jokorrekte dhe normale, aq më tepër që edhe përgjigjja e drejtoreshës këtu ishte jo shumë e saktë, madje tha: “Kemi 12 programe, por nuk kam databazë që të jap të dhëna të sakta se cilat janë këto programe”.

Mendoj se ky projekt duhet të vinte më i organizuar, më serioz, më i drejtpërdrejtë, të vinte në kohën e duhur dhe me programe konkrete, pra jo me këtë disnivel, që ne përfitojmë vetëm në 2 bashki, ndërsa Kosova përfiton në 8 bashki dhe, nga ana tjetër, ky bashkëpunim ka filluar në vitin 2014, në vitin 2016 ka filluar rialokimi i fondeve, ndërsa sot, në vitin 2018, ne miratojmë një projektligj të tillë duke mos ditur shpenzimet dhe të ardhurat e çdo shteti që do të paguajë.

Në qoftë se ne do t’i paguajmë 180 mijë euro kontributit tonë, ndërkohë që kontributi i BE-së është 1 milionë e 200 mijë euro, atëherë unë dua të di: sa është kontributi që paguajmë, sepse unë votoj këtu në parlament? Pra, meqenëse votoj, duhet ta di kontributin që paguajmë ne. Mund të mos jetë 180 mijë euro, mund të jetë shumë herë më pak, sepse kemi më pak bashki që përfitojnë

apo OJF të tjera që përfitojnë dhe realisht projekti duhet të vinte i detajuar në rastin konkret, që ne të jemi të qartë për atë çfarë bëjmë dhe votojmë.

Më duket se projektligji nuk është i saktë, nuk është formatuar drejt dhe saktë qoftë edhe për kohën që ka kaluar, qoftë edhe për kohën e vonuar që ne po e votojmë sot në parlament. Unë jam kundër saj.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Fino!

Fjalën e kanë përfaqësuesit e Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Bashkim Fino** – Jo, nuk ka nevojë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ulsi Manja** – Një sqarim.

**Bashkim Fino** – Për procedurë, zoti kryetar!

Të lutem, respekto Rregulloren!

Të dëgjova me kujdes, folën zotërinjtë, foli relatori...

**Ulsi Manja** – Zoti Fino, ju lutem!

**Bashkim Fino** – ...u bënë pyetjet, filluan diskutimet!

**Ulsi Manja** – Zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Ky që bëra unë ishte diskutim.

**Ulsi Manja** – Zoti Fino...

**Bashkim Fino** – Të lutem, se nuk kam mbaruar! Pas meje çdo koleg mund të diskutojë dhe, pas diskutimit, keni të drejtën të bëni konkluzionet...

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Jeni kryetar i komisionit? Debatin...

**Ulsi Manja** – Ju lutem!

**Bashkim Fino** – Nuk mundeni ju, zoti kryetar, që pas diskutimit tim t'u jepni fjalën përfaqësuesve të ministrisë! Absolutisht jo!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Kështu thotë Rregullorja!

**Ulsi Manja** – Ju lutem, zoti Fino!

**Bashkim Fino** – Jo, ju lutem unë!

**Ulsi Manja** – Është projektligj i qeverisë sonë ky, nuk është i opozitës, ndaj, ju lutem...!

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Sqarojmë qytetarët.

Ka diskutime të tjera këtu?

*(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)*

Ju lutem tani!

**Bashkim Fino** – Jo, zoti kryetar, ju lutem!

**Ulsi Manja** – Ka diskutime të tjera?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Zoti Fino, e kam unë drejtimin e mbledhjes.

Ka diskutime të tjera nga kolegët?

Kush do të diskutojë? Nuk ka diskutime.

Kanë për të thënë diçka përfaqësuesit e ministrisë, për sa i takon asaj që ngriti zoti Fino?

**Danjela Çekani** - Faleminderit!

Duhet ta sqarojmë, sepse projektligje të tilla miratohen çdo ditë. Programi ka lidhje me ...

**Ulsi Manja** – Desha të më sqaroni, për sa i takon shqetësimit që ngriti zoti Fino. Nuk dua detaje për marrëveshjen.

**Danjela Çekani** – Vetëm këtë duam të sqarojmë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Miratimi i alokimeve vjetore parashikohet në rregulloren IPA. Programi ka një kohëzgjatje 7-vjeçare dhe Komisioni Europian ndjek një rregull të quajtur 9+3, pra alokimet janë vjetore dhe alokimet e vitit 2016 kontraktohen në vitin 2019. Fakti që këto marrëveshje kalojnë për ratifikim në parlament, është bërë pas një interpretimi të dhënë së fundi nga Ministria e Financave, pasi më parë mjaftonte vetëm një VKM për ta miratuar. Efektet financiare të kësaj marrëveshjeje fillojnë direkt mbas miratimit të VKM-së. Pra, nuk shkakton problematikë se sa më pas në kohë ne e ratifikojnë. Sigurisht, mbas VKM-së kërkohet firmosje nga të gjitha palët, duke përfshirë Komisionit Europian, përfaqësuesit shqiptarë dhe përfaqësuesit kosovarë, procedurë, e cila merr kohë, në varësi të procedurave të vendeve respektive të çdo shteti. Ky nuk është thjesht një projekt, por është një program dhe Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme është në rolin e

koordinatorit kombëtar të fondit IPA, i cili bën të mundur koordinimin e prioriteteve të shtetit shqiptar së bashku me atë kosovar dhe miratimin e programit në fund, sigurisht me miratimin e Komisionit European.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

**Rovena Voda** - Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Hedhim në votim në parim këtë projektligj.

Kush është pro në parim? Kush është kundër? 2 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim ky projektligj.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është dakord në tërësi me këtë projektligj?

Kush është pro? Kush është kundër? 2 vota kundër.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2016”.

Ky projektligj, së bashku me raportin e Komisionit të Ligjeve, do t’i përcillet komisionit përgjegjës për vlerësim e më pas, seancës plenare për votim.

Urdhëroni, zoti Fino për shpjegim vote!

**Bashkim Fino** – Unë votova kundër, ashtu siç thashë edhe në diskutimin tim, thjesht për seriozitetin e përgatitjes së materialit, për programet dhe për përfitimin, që duhet të marrim. Në parim ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe nuk ka arsye të votohet kundër, por për sa i përket relacionit të projektligjit dhe vlerësimit të të ardhurave të shpenzimeve buxhetore, të cilat duhet të jenë të sakta, ndërsa këtu në relacion, për mendimin tim, mungojnë dhe nuk janë të sakta,

megjithëse ju u munduat t'ia jepnit fjalën jashtë Rregullores përfaqësuesit të qeverisë, në një kohë kur kishin mbaruar diskutimet.

Kjo është pikërisht arsyeja pse votova kundër. Ky relacion duhet të ishte më i saktë dhe më i plotë dhe mendoj se ju, si kryetar i komisionit, që keni të drejtë të bëni konkluzionet dhe të veproni, besova se do ta mirëprisnit vërejtjen time dhe ndoshta do të linit disa detyra për përfaqësuesit e qeverisë, që ata të na binin një relacion më të detajuar dhe më të saktë, deri në kryerjen në seancë plenare të votimit, e cila do të na kënaqte. Në thelb nuk jam kundër me këtë marrëveshje, por vetë relacioni ka shumë mangësi për të cilat ne duhet të informojmë.

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

**Alket Hyseni** – Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse roli i këtij komisioni, roli ynë si deputetë është që jo vetëm të suportojmë qeverinë, por edhe nëpërmjet aksioneve tona, përmes votës, diskutimit, pyetjeve që shtrojmë, ta ndihmojmë qeverinë dhe projektin e saj që është absolutisht edhe projekti ynë. Shpeshherë mund të ndodhë që procedurat e ndjekura të mos jenë perfekte dhe nëse ne nuk e bëjmë filtrin e duhur, nuk e ndihmojmë fare e qeverinë. Ne nuk jemi këtu për t'u bërë shtojca të gabimeve, të vonesave rast pas rasti dhe këtu nuk është fare çështja, se unë jam dakord në parim me thelbin e këtij projektligji, por unë mendoj që disa vërejtje duhet të merren parasysh. Ne jemi komision për dhënie mendimi. Le të shërbejnë vërejtjet që bëme këtu dhe vota jonë kundër, jo ndaj kësaj ministrie, por ndaj të gjitha ministrive, që ato t'i sjellin më në rregull projektligjet, që herën tjetër edhe diskutimi të jetë më i saktë dhe të gëzojë patjetër, votën e të gjithë deputetëve tanë. Vota kundër nuk do të thotë fare, që ka ndonjë problematikë politike. Ajo ka të bëjë me aspekte procedurale.

Po ashtu, e mbështes zotin Fino. Është përgjegjësia jonë dhe juaja, zoti kryetar që t'i japim peshën këtij komisioni. Pas diskutimeve, nuk mund t'i jepet fjala askujt nga ministria.

Faleminderit!

**Ulsi Manja** – Faleminderit!

E para, vota në parim kundër, nuk do të thotë që jeni dakord me thelbin e projektligjit. Vota në parim kundër, do të thotë që jeni kundër në parim, ndërsa lidhur me procedurat...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ju lutem!

Lidhur me procedurat, me miratimin nen për nen dhe në tërësi, është tjetër gjë. Secili nga deputetët ka mendimin e tij për nene të caktuara dhe për projektligjin në tërësi. Vota në parim është votë politike.

Mbledhja e sotme e komisionit mbyllet këtu. Sigurisht, ky komision është në mbështetje të çdo nisme dhe çdo aksioni të qeverisë, një ndër të cilat është edhe projektligji, që sapo votuam sot. Vota në parim është votë politike.

Faleminderit!

Këtu e mbylлим mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Ditë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**